


20/06/2023

Hierodëshmor Metodi i Patarës. Oshënar Nikolla Kavasila. Kalisti i Konstandinopojës.



E martë, 20 qershor 2023 - Shenjtori i ditës.

JEMI NË KRESHMËN E APOSTUJVE

Hierodëshmor Metodi i Patarës. Oshënar Nikolla Kavasila. Kalisti i Konstandinopojës.



- SHËN METODI I PATARËS -

Shën Metodi iu përkushtua Zotit që kur ishte fëmijë. Më vonë u hirotonis episkop i Patarës - ose më saktë i Olimpit - të Likisë. I famshëm për kulturën e tij filozofike dhe për zellin për të vërtetën ungjillore, mori pjesë në diskutimet për dogmën e Ngjalljes. Vizitoi qytetet kryesore të Likisë dhe Pamfilisë dhe udhëtoi në shumë krahina të largëta për të mbrojtur besimin e vërtetë përballë filozofëve paganë.

Në përgjigje të Platonit, i cili i thurte elozhe erosit dhe pretendonte të lartësonte dashurinë nga një lidhje me gjërat e trupit, drejt realiteteve shpirtërore, shenjtori hartoi një apologji të fortë për virgjërinë dhe për jetën e virtytshme të krishterë: "Banketi i Dhjetë Virgjërëshave". Ai e paraqet veprën e tij në mënyrë platoniane, si një bisedë që zhvillohet në kopshtin e Zonjës Virtyt, motër e Filozofisë, që ishte e mbjellë, ashtu si Parajsja, në Lindje, gjatë së cilës dhjetë virgjërësha marrin fjalën për të mburrur virgjërinë.

Markela, virgjërësha e parë, e lavdëron virgjërinë si një virtyt që ushtrohet në tokë, por që e lartëson në qiell shpirtin e atij që e adopton dhe e çon drejt paprishshmërisë dhe në ngjashmërinë me Perëndinë sipas imitimit të Krishtit, i cili është "I Virgjëri në tërë kuptimin e fjalës". Ajo na zbulon fundin e pedagogjisë që ka përdorur Perëndia për ta çuar njerëzimin drejt përsosmërisë: duke lejuar fillimisht lidhjet incestive, pastaj poligaminë, për t'i lënë vend pastaj pastërtisë morale në martesën e vetme dhe në fund fare vjen virgjëria.

Theofilia ndërhyt në këtë moment për të sqaruar se martesë nuk duhet aspak të përbuzet dhe thotë: “Nëse mjalti është më i ëmbël se ushqimet e tjera, kjo nuk do të thotë se këto ushqime janë të hidhura”. Kisha është e ngjashme me një kopsht që ka lule të ndryshme dhe disa janë lulet e virgjërisë, disa janë ato të familjes dhe të tjerat të dëlirësisë. Në fund të fjalës së saj, të gjitha virgjëreshat duartrokitën për të treguar aprovimin dhe vlerësimin e tyre për martesën.

Thalia, virgjëresha e tretë, mbështeti mendimin se, nëse bashkimi i burrit dhe gruas është simboli i Krishtit dhe i Kishës (shih Efes. 5:16), virgjëria është një martesë shpirtërore, që e plotëson me të vërtetë këtë Mister të Madh të bashkimit të shpirtit me Dhëndrin Krisht. Dhe shtoi, nëse martesë iu dha njerëzimit për shkak të mëkatit, virgjëria është një dhuratë e Perëndisë.

Theopatra e plotësoi këtë fjalë duke thënë se asgjë nuk e ndihmon më tepër restaurimin e jetës së parajsës, të pajtimit me Perëndinë dhe paprishshmërisë, sesa jeta e dëlirë.

Pastaj Thalasia shpalli se i virgjëri, që të jetë me të vërtetë i denjë për këtë emër, duhet ta ruajë veten të pastër, në tërësi, duke ia përkushtuar Perëndisë të gjitha lëvizjet e trupit dhe të shpirtit dhe se dëlirësisë trupore duhet t’i shtojë edhe atë të gojës, të syve, të dëgjimit, të prekjes dhe mbi të gjitha dëlirësinë e zemrës, e cila, e frymëzuar vetëm nga Perëndia, nuk mendon më asgjë të kësaj bote dhe nuk bie pre e inatit dhe e lavdidashjes.

Agathia përdori shëmbëlltyrën e Dhjetë Virgjëreshave (shih Matth. 25:1-13), për të treguar se virgjëria duhet të ruhet me shumë kujdes nga sulmet e shturjes.

Pastaj fjala iu dha Prosilës, e cila, duke iu rikthyer aspektit teologjik të çështjes, deklaroi se mishi i Krishtit është nusja e parë që mori Fjala, për ta vendosur, si mbretëreshë, në të djathtë të Atit. Ajo madje e lavdëroi virgjërinë si diçka më të lartë edhe se martirizimi, sepse nuk përbën vetëm durimin e një sprove për një kohë të shkurtër, por do të thotë të durosh sulmet e epshit gjatë gjithë jetës.

Radha i erdhi edhe Theklës, e cila admirohej nga virgjëreshat e tjera për njohuritë e thella rreth filozofisë, si asaj njerëzore ashtu edhe të hyjnore.

Ajo bëri ekspozitën më të gjatë dhe lavdëroi në veçanti virgjërinë si mjet për të nxjerrë deduksionin etimologjik, se në gjuhën greke virgjëri – parthenia, do të thotë “të qëndrosh pranë Perëndisë” (para-Theon).


Diskutimi përfundoi me ligjëratat e Tisianës dhe të Dominës, që zhvilluan të dyja veçmas interpretimet alegorike të Dhiatës së Vjetër.

Zonja Areti (në greqisht, Virtyt) mori fjalën për të përfunduar se virgjëria nuk mund të kufizohet në vetpërmbajtjen seksuale, por ndodhet në përkushtimin e plotë të Perëndia të të gjitha lëvizjeve të shpirtit e të ndjenjave dhe i dha kurorën Theklës.

Gjatë udhëtimit të tij, shën Metodi iu kundërvu gnostikëve dhe heretikëve që përbuznin trupin dhe krijesën e dukshme, duke provuar se asgjë e keqe nuk është

krijuar prej Perëndisë. Por ai ishte i pari që nxori në pah gabimet e Origjenit dhe që e luftoi me forcë doktrinën e tij mbi paraekzistencën e shpirtave dhe rënien e tyre në trup si në një burg, një koncept që sillte për pasojë mohimin e ngjalljes së trupit. Pasi luftoi për shumë kohë për të vërtetën, shën Metodit i prenë kokën në Halkidë (Siri), me shumë gjasa gjatë persekutimit të Licinit (rreth vitit 311).

* * * * *



- OSHËNAR NIKOLLA KAVASILA -

Lindi në Selanik rreth vitit 1322. Mbahti mbiemrin e familjes të së ëmës, Kavasila, familje e vjetër dhe e shquar. Që i ri mori formim shpirtëror nga Dhorotheu i Vlatit, nxënës i afërt i shën Grigor Pallamait. Frekuentonte qarqe të shenjta laikësh, të cilët jepeshin te Lutja e Jisuit nën drejtimin e shën Isidor Bukiras, patriarku i ardhshëm (1347-1350). Pasi mori formimin letrar e filozofik pranë dajës, Nil Kavasila, u bë një nga etërit shpirtërorë më të njohur të Selanikut. Bashkë me vëllain, Markun, themeluan manastirin e Pantokratorit (1355), i cili mban sot emrin

e tyre (Vlatadhon), para se të bëhej mitropolit i Selanikut (1371-1379). I vazhdoi studimet edhe në Shkollën e Filozofisë në Konstandinopojë.

Arriti një kulturë letrare mjaft të lartë dhe admirimi i tij për antikitetin klasik e bëri të rreshtohej në radhët e humanistëve, pa u shkëputur nga mësimi i Kishës. Gjatë qëndrimit në kryeqytet, debati mes Grigor Pallamait dhe Varlaamit rreth mundësisë për hyjnizimin e njeriut nga energjitë e pakrijuara të Hirit, tërhoqi vëmendjen e tij mbi qëllimin e jetës së krishterë, por u dha më shumë pas problemeve sociale e politike të kohës. Pas vdekjes së Andronikut III (1341), perandoria pësoi përcarje nga lufta civile mes partizanëve të Joanit V Paleologut dhe atyre të Joan Kantakuzenit, situatë e cila rëndohej edhe me revoltën e zelotëve në Selanik kundër pushtetit perandorak dhe fisnikëve.

Nikolla ishte në Selanik dhe mori iniciativën të bënte negociata midis kryengritësve dhe Joan Kantakuzenit. Më 1345, u dërgua në Veria, pranë birit dhe përfaqësuesit të Kantakuzenit, Manuelit, me këtë detyrë përfaqësimi. Por, kur u kthye prej andej, Andrea Paleologu e kundërshtoi këtë plan dhe, duke i nxitur zelotët dhe popullsinë e lagjeve të lëna pas dore, pushtoi qytetin ku strehoheshin fisnikët. Masakrat ishin të panumërta dhe Nikolla mundi të shpëtonte duke u fshehur në një pus. Qëndroi pa u shqetësuar në Selanik deri më 1347, me gjithë simpatinë që kishte për Kantakuzenin. Mendonte shkaqet e luftës civile, ndaj hartoi edhe shkrime kundër padrejtësisë sociale. Kur Kantakuzeni hipi në fron me titullin Joani VI, e thirri Nikollën në Konstandinopojë dhe e bëri këshilltarin e tij për çështje të rëndësishme të shtetit.

Nën ndikimin e dy këshilltarëve, Nikollës dhe mikut të tij të fëmijërisë, Dhimitër Kidhonisë, sovrani vendosi të tërhoqej në manastirin e Manganëve, por hoqi dorë nga ky vendim për shkak të situatës politike në Selanik. Gjatë gjithë kësaj periudhe, Nikolla shkruante dhe mernte pjesë aktivisht në jetën publike në Selanik. Në shtator 1347, bënte pjesë në grupin që shoqëronte shën Grigor Pallamain, i cili ishte zgjedhur sërish kryepiskop i Selanikut; por pasi populli e hodhi poshtë bariun e tij, ata u tërhoqën në Malin e Shenjtë, ku jetuan në qetësi dhe lutje për një vit. Më 1349 u kthye përsëri në Selanik, ku zelotët ishin pajtuar me partitë kundërshtarë dhe u krye edhe fronëzimi i shën Grigorit.

Më 1351, gjatë sinodit që dënoi Akindinin dhe e shpalli hezikastinë si doktrinë zyrtare të Kishës, Kavasila shpalli hapur teologjinë palamike, dhe shpalli se ishte pro për sinodin e bashkimit me Kishën Latine, por pa kompromis doktrinal, ndërkohë që miku i tij, Kidhoni, u radhit mes kundërshtarëve të hezikastisë dhe mbajti një qëndrim nënshtrimi ndaj tezave latine. Një luftë e re civile shpërtheu mes Joanit V Paleologut dhe Joan Kantakuzenit (1353), që pati si pasojë heqjen e patriarkut shën Kalisti. Emri i Kavasilës u propozua si pasues i mundshëm, por përfundimisht u zgjodh shën Filotheu (11 tetor).

Një vit më vonë, Nikolla përshëndeti me një fjalim të shkëlqyer kurorëzimin e Mattheo Kantakuzenit si perandor; por më vonë Joan Paleologu e mori pushtetin me mbështetjen e ushtarëve dhe Joan Kantakuzeni u tërhoq dhe u bë murg me emrin Joasaf. Patriarkun Filothe e hoqën dhe e internuan, dhe Kalistin e sollën përsëri në fronin episkopal. Që atëherë, Nikolla u tërhoq nga çështjet publike. Nuk e dimë nëse qëndroi deri në fund të jetës së tij një laik hezikast apo u bë murg, siç e supozojnë disa shkrime të tjera.

Gjatë kësaj periudhe të gjatë tërheqjeje, përveç një qëndrimi 2-vjeçar në Selanik, ai qëndroi në Konstandinopojë duke vizituar shpesh manastirin e Manganëve, të Ksanthopulit dhe të Studitëve. Të gjithë e njihnin si një njeri që kishte arritur majën e virtytit. I shmangu ftesat që të angazhohej në trazirat e botës, duke preferuar të qëndronte në heshtje për të hartuar dy ligjëratat e tij të mëdha: “Interpretimi i Liturgjisë Hyjnore” dhe “Jeta në Krishtin”, të cilat dëshmojnë shenjtërinë e tij dhe konsiderohen si dy kryevepra të literaturës së krishterë. Fjeti në paqe, midis 1391 ose 1397.

Në veprën e tij “Jeta në Krishtin”, ai tregon se si, duke marrë qenien, lëvizjen dhe jetën e vërtetë përmes Mistereve të Shenjta: Pagëzimit, Mirosjes dhe Eukaristisë dhe, duke u rritur shpirtërisht në virtyt, besimtarët mund të kuptojnë se vetë Krishti me anë të Frymës së Shenjtë vjen të banojë dhe të rritet tek ne, deri në përmbushjen e bashkimit të përsosur me Perëndinë.

Shën Nikolla Kavasila, humanist në formim, por me thirrje hezikaste, tregoi se hyjnizimi dhe bashkimi më Krishtin përbëjnë qëllimin e jetës shpirtërore të çdo të krishteri dhe jo vetëm të murgjve.

[Kisha Orthodhokse Autoqefale e Shqipërisë](#)